



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Prilidheni / Prodato Received / Delivery	20.12.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMBAHX	6237/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.907/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani - kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Zyle Millaku-Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës të datës 05.11.2021 me numër A.nr.907/2019 të parashtruar nga ankuesja përmes formës elektronike (E-mail të datës 05.11.2021), me adresë Policia e Kosovës në Divizionin e Trajnimeve – Zyra e bazës së të Dhënave, kundër organit të punësimit policisë së Kosovës, në çështjen juridike, kompensim material, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.907/2021 e datës 05.11.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës, në pozitën "Zyrtare e Bazës së të Dhënave", në Divizionin e Trajnimeve, Drejtoria e Përgjithshme, sipas Kontratës nr. referencës:07/1-01A/0193 të datës 06.11.2012, ka parashtruar ankesë me datë 05.11.2021 me numër protokoll 5317/2021 e regjistruar me A.nr.907/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shtesë në pagë sipas Vendimit Nr.02-39 dhe nr.:07/39 (Aneksi) për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën A.nr.907/2021 të datës 05.11.2021 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili i datës 05.11.2021; Kontarta e punës nr. referencës:07/1-01A/0193 të datës 06.11.2012; Vërtetimi i punës i datës 25.05.2021; Njoftimi i datë 06.09.2021 me nr. protokoll 4506/2021, sipas ankesës me numër A.nr.678/2021 të datës 23.07.2021 numër protokoll 3876/2021 e të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të gjithave shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses

është e pa lejuar, sepse

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja me datë 23.07.2021 numër protokoli 3876/2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër të regjistruar A.nr.678/2021, për të njëjtin objekt ankimor, gjegjësisht pretendimet e njëjta duke pretenduar shtesë në pagën bazë edhe në ankesën e dytë me datë 05.11.2021, sipas Vendimit Nr.02-39 dhe nr.:07/39 (Aneksi) për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës, për të cilën ankesë ka pranuar njoftimin e datës 06.09.2021 me nr. protokoli 4506/2021, lidhur me mos funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, **citohj:** *"...Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ju informojmë që në bazë të legjislacionit pozitiv keni të drejt ti ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative".*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , ka konstatuar se ankuesja kundër njoftimit të datës 06.09.2021 me nr. protokoli 4506/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka pasur mundësi për të iniciuar procedurën administrative në konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ, e jo siç ka vepruar në rastin konkret duke ripërsëritur të njëjtën ankesë me datë 05.11.2021, me numër protokoli 5317/2021 e regjistruar me A.nr.907/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar në shtesën në pagë bazë sipas Vendimit Nr.02-39 dhe nr.:07/39(Aneksi) për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , ka konstatuar se në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të nenit 24 paragrafi 3 të këtij Ligji, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, duke u lidhur me dispozitën ligjore të nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet afati i ankesës, citohj" **1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"**, që në rastin konkret ankuesja me rastin e ri përsëritjes së ankesës nga data 23.07.2021 edhe me datë 05.11.2021 për të njëjtës çështje në Këshill, ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartë cekur.

Andaj, duke u bazuar të dispozitat ligjore si më lartë dhe duke marrë parasysh se ankuesja lidhur me ankesën e parë të datës 23.07.2021 është njoftua me datë 06.09.2021 për mos funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kolegji konstaton se ankuesja me datë 05.11.2021 ka parashtruar ankesën e dytë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të njëjtën çështje, e cila është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kundërshtim me Njoftimin e datës 06.09.2021, ku është udhëzuar për procedurat e mëtejme në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.907/2021,

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet :

- Ankuesja
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore/Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.